



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo  
ODA E STOMATOLOGJËVE TË KOSOVËS  
STOMATOLOŠKA KOMORA I KOSOVA  
DENTAL CHAMBER OF KOSOVA  
Nr.Br.No. 1062 Dt 26.12.2019



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

## **RREGULLORE PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE PËR ANËTARËT E OSK-së**

Prishtinë, dhjetor 2019

**KUVENDI I ODËS STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së)** në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Lgjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 21.dhjetor 2019, miraton tekstin e spastruar të Rregullores së përkohëshme për solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së.

Teksti i spastruar përfshin Rregulloren e përkohëshme për solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së, miratuar me 25 qershor 2019 nga Këshilli Drejtues, me autorizim të Kuvendit të datës 14.maj 2019.

## RREGULLORE PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE PËR ANËTARËT E OSK-së

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara nga Kuvendi i OSK-së, me datë 21.12.2019)

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fushëveprimtaria e Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë reciproke (në vazhdim Komisioni) i cili jep mbështetje financiare anëtarëve të OSK-së (tash e tutje Oda), ku përcaktohen burimi i mjeteve, qëllimi dhe shuma, kushtet dhe procedura për dhënien e ndihmës anëtarëve të Odës.

#### Neni 2

Për dhënien e ndihmës sipas nenit 1 të kësaj Rregullore, Oda krijon një fond të posaçëm.

#### Neni 3

##### Sigurimi i mjeteve të Fondit

1. Mjetet e Fondit sigurohen nga:
  - 1.1. kontributet vullnetare të anëtarëve të Odës dhe personave të tjerë juridik e fizik,
  - 1.2 gjobat e mbledhura nga masat disiplinore të shqiptuara,
  - 1.3 mjetet financiare sipas ndarjes buxhetore.

#### Neni 4

Mbikëqyrja e mjeteve të Fondit bëhet nga Këshilli Drejtues i Odës dhe Këshilli Mbikëqyrës i Odës.

**Neni 5**  
**Mbështetja/ dhënia e ndihmës financiare**

1. Mbështetja/ndihma financiare i takon anëtarit të Odës në rast të:

- 1.1 Humbjes së aftësisë (invaliditetit) të përcaktuar me vendim të organit kompetent, në përqindje më të madhe se 80%, për shkak të të cilës anëtari nuk mund ta kryejë në mënyrë të përhershme veprimtarinë mjekësore.
- 1.2 Shfaqjes së sëmundjes së rëndë për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbuloj kostot e shpenzimeve, qoftë brenda apo jashtë vendit.

**Neni 6**

Secili anëtar i Odës i cili rregullisht paguan anëtarësinë ka të drejtë në mbështetje/ndihmë financiare sipas nenit paraprak.

**Neni 7**

**Kriteret objektive për dhënie të ndihmës**

Komisioni gjatë shqyrtimit të kërkesave për ndihmë financiare, krahas kriterëve subjektive të përcaktuara në Nenin 5 të kësaj rregulloreje, do të konstatojë nevojën për dhënie të ndihmës solidare duke u mbështetur edhe në kritere objektive.

**Neni 8**

Shuma për mbështetje financiare nga Neni 5 i kësaj rregulloreje e përcakton Komisioni për mbështetje/ndihmë financiare, në varësi të shumës së mjeteve në Fond.

**Neni 9**

**Procedura për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare**

1. Anëtari i Odës, respektivisht i autorizuari për të drejtën për ndihmë, ia paraqet Komisionit një kërkesë me shkrim për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare. Kërkesës i bashkangjitet dokumentacioni përkatës me të cilin vërtetohet baza për të kërkuar ndihmë (kopje të dokumenteve mjekësore, profatura, fatura si dhe dëshmi tjera relevante).
2. Kërkesa për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare në rastet e specifikuara në dispozitën e nenit 5, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 të kësaj Rregulloreje dorëzohet tek Komisioni për vlerësimin e saj pas identifikimit dhe diagnostikimit me sëmundjen e rëndë të anëtarit/anëtares të Odës ose humbjes së aftësisë për punë.

### **Neni 10**

1. Ndihma financiare paguhet në mënyrë të njehershme për secilin anëtar/e pas parashtrimit të kërkesës për dhënie e ndihmës financiare dhe pas aprovimit të së njëjtës me vendim nga Komisioni.
2. Në rast se kërkesa është jo e plotë, Komisioni do të kërkojë nga parashtruesi që të plotësojë të njëjtën brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.
3. Nëse parashtruesi nuk e dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, Komisioni do ta refuzojë kërkesën me vendim.

### **Neni 11**

1. Komisioni merr vendim për kërkesën e paraqitur nga parashtruesi, anëtari i Odës.
2. Kundër vendimit të Komisionit, parashtruesi mund të paraqet ankesë në Këshillin Drejtues të Odës.
3. Ankesa parashtrohet brenda 15 ditëve pas pranimit të vendimit të Komisionit.
4. Këshilli Drejtues i Odës është i detyruar të kthejë përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga data e pranimit të ankesës.
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të Odës është i formës së prerë, dhe nuk mund të atakohet tutje me procedurën e ankimimit.

### **Neni 12**

1. Zyrtari administrativ që asiston Komisionin është i detyruar të mbajë një regjistër të të gjitha kërkesave të pranuar për mbështetje/ndihmë financiare.
2. Shërbimi financiar i Odës mban regjistrin për mjetet e ndara.

### **Neni 13**

Komisioni është i detyruar të dorëzojë një raport mbi punën e tij në Këshillin Drejtues dhe Këshillin Mbikqyrës, dy (2) herë në vit apo çdo gjashtë (6) muaj.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 14

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendii Odës.

Prishtinë, 21 dhjetor 2019



Kryetari i OSK-së

Prof.Dr.Blerim Kamberi